

Urdhër nr. 266/1, datë 1.9.2020 “Për marrjen e masave të veçanta nga komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga covid-19”

Ky urdhër vendos që: 1. Komisionet mjekësore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe epror, të cilat funksionojnë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shërbimit Social Shtetëror, Komisioni Mjekësor i Përcaktimit të Verbërisë i nivelit të parë dhe Epror, si dhe komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar të nivelit të parë dhe të dytë, që funksionojnë pranë Shërbimit Social Shtetëror, të cilat kanë qenë të pezulluara për shkak të epidemisë COVID-19, nisin funksionimin e tyre, duke respektuar masat për parandalimin e përhapjes së infeksionit, sipas përcaktimeve në këtë urdhër. 2. Afatet e parashikuara sipas rregulloreve të Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore të mos aplikohen për periudhën e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë, COVID-19.

Urdhri nr. 226, datë 2.4.2020, shfuqizohet.

Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Shërbimi Social Shtetëror, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe komisionet e vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës të nivelit të parë dhe epror.

Urdhërin e plotë e gjeni në: <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2020/09/01/266-1/477d2791-f966-4c8a-957c-0555436c6de2>